

I E K A
Sabri PALAMANI

RAPORT I PERGJITHSHEM I EKSPERTEVE KONTABEL TË AUTORIZUAR

USHTRIMI 2002
(Mbyllur me 31.08.2002)

TË NDERUAR Zoterinj të
Shoqerise "EMIS" Shpk.
me kapital themeltar prej 100,000 lek
Adresa: Rr "Pjeter Bogdani"
Tirane

Ne ekzekutim të misionit qe na eshte besuar nga drejtimi i shoqerise "EMIS" Shpk, kemi nderin t'ju paraqesim Raportin tone mbi llogarite vjetore të ushtrimit, qe mbulon periudhen nga 01.01.2002 deri me 31.08.2002

Raporti permban dy pjese:

. kontrollin e llogarive vjetore të Shoqerise suaj , të tilla siç i jane aneksuar Raportit prezent,

. vertetimet dhe informacionet specifike të parashikuara nga ligji, qe kane të bejne me ushtrimin 2002 qe mbulon periudhen nga 1 janari deri me 31 gusht 2002.

I. OPINIONE MBI LLOGARITE VJETORE

Kemi kryer kontrollin e llogarive vjetore të periudhes qe mbyllet me 31.08.2002 ne perputhje me normat profesionale , me ligjin "Për kontabilitetin" dhe ligje e dispozita të fushes. Për realizimin e misionit kemi perdorur teknikat e nevojshme të kontrollit, pa ndermarre ne asnje rast nje verifikim të plote të operacioneve të kryera nga shoqeria juaj e të regjistruara prej kontabilitetit për as nje pjese të ushtrimit. Ne besojme se

puna kontrolluese e bere nga ana jone siguron baza të mjaftueshme për mbeshtetjen e këtij opinioni.

Shoqeria juaj mban regjistrimet kontabile ne menyre manualr te cilat i perdor për grumbullimin e informacionit të nevojshem.

Kontabiliteti i shoqerise dhe regjistrimet perkatese ne të behen bazuar ne dokumentat baze kontabel , ne to paraqiten veprimet e levizjeve të aktiveve , kapitalit e detyrimeve dhe regjistrohen ne perputhje me rregullat perkatese kontabile.

Ne audituam bilancin kontabel nga ku rezulton rregullsi e korrektese formale ne kuadraturat respektive të tij , si për vitin ushtrimor ashtu dhe për vitin e kaluar. Po keshtu edhe llogaria “Humbje-Fitime ” e shoqerise “EMIS” Shpk dhe anekset e tjera të llogaridhenies vjetore qe shoqerojne bilancin kenaqin kerkesat e ligjes.

Keto pasqyra financiare jane ndertuar nen pergjegjesine e drejtimit të shoqerise .

Ne perfundim të kontrollit tone, ne jami ne gjendje të vertetojme se llogarite vjetore ,qe i aneksohen këtij Raporti jane të rregullta, të sinqerta dhe japin nje pamje besnike të rezultatit nga veprimet e ushtrimit rrjedhes si dhe të situates financiare dhe të gjendjes pasurore të Shoqerise suaj me 31.08.2002.

II - VERIFIKIME DHE INFORMACIONE SPECIFIKE


Ne kemi verifikuar sinqeritetin e informacioneve të tipit kontabel qe figurojne ne Raportin e drejtimit, dokumenta të bilancit e të tjera ,qe i jane adresuar ose vene ne dispozicion të drejtimit të Shoqerise tuaj. Ato jane ndertuar ne perputhje me kete tip shoqerie.

Për keto dokumenta nuk ka verejtje nga ana jone.

Tirane, 28 Shkurt 2002

Ekspert Kontabel i Autorizuar

Sabri PALAMANI Nr LIC 125



SHOQERIA "EMIS" Shpk
Shenime për Deklarimet Financiare
Periudha 01.01.2002 – 31.08.2002

SHENIME PËR DEKLARIMET FINANCIARE

I. Organizimi, Objekti i Veprimtarise, Pronesia, Kapitali dhe Administrimi

Organizimi

Shoqeria "EMIS" shpk eshte krijuar si shoqeri me pergjegjisi të kufizuar me Vendim të Gjykates se Rrethit Tirane Nr15829 date 17.09.1996 .Themelues i shoqerise eshte ortakut i vetem Z. Sokol Coku. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese të Ligjit 7638 date 19.11.1992, "Për shoqerite tregtare" si dhe nga statuti dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Objekti i veprimtarise :

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne fushen e Import - eksport dhe tregetim e mallrave te ndryshme.

Kapitali

Kapitali i shoqerise sipas vendimit të gjykates se Rrethit Tirane perbehet nga kontributi i ortakut te vetem , ne shumen 100,000 leke .

Administrimi

Shoqeria "EMIS" shpk. drejtohet nga administratori (ortak i vetem) Z. Sokol Coku deri ne momentin e humbjes se jetes. Me pas me vendim te gjykates se rrethit Tiranes Nr. 15829/1 date 30.10.02 pronesia dhe drejtimi i shoqerise i kaluan Zonjes Ema Coku.

PASIVI

Kapitalet e veta jane : -1,248,739 leke,të cilat klasifikohen si meposhte:

Kapitali i nenshkuar, 100,000 leke. Shuma e regjistruar ne kete post ka ndryshuar me ate të ushtrimit paraardhes , kjo mbeshtetet ne aktin e themelimit , ne statut dhe ne vendimin gjyqesor nr 15829 date 10.09.1996 .

Rezervat ligjore, Shoqeria nga fitimet ka krijuar rezerven ligjore ne shumen 19,834 leke.

SHOQERIA "EMIS" Shpk
Shenime për Deklarimet Financiare
Periudha 01.01.2002 – 31.08.2002

Fitime te mbartura , 3,744,181 leke

Rezultati i ushtrimit, - 5,112,754 leke. Ky rezultat eshte konfirmuar edhe nga kontolli i deges se tatimeve e cila ka leshuar vertetimin perkates te cilat jane dorzuar prane gjykates..

Detyrimet

Ne postin Ortake , ne pasiv të bilancit paraqitet shuma prej leke 1,248,739 si detyrim i shoqerise karshi ortakut te vetem.

Sikunder shifet nga te dhenat e mesiperme shoqeria paraqitet ne nje suate te favoreshme likujdimi. Ajo ka humbur kapitalet e veta dhe nuk zoteron aktive per shlyerjen e detyrimit ndaj ortakut te vetem. Ne keto kushte aktiviteti i shoqerise paraqitet i mbyllur.

